

## Drejtoria Rajonale Burrel

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Burrel, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT** **(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

**Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomik: “ABG Ndertim” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K03816401O, me seli: Tiranë, Tiranë, TIRANË, Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga “Ali Demi”, Ambientet e ish Kombinatit Poligrafik, Godinë 2 Katëshe, ngjitur me Spitalin Continental, Pronë e Kryegjyshitës Bektashiane, Tiranë, Shqipëri, dhe “LA - OR” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K71420003R, me seli: Tiranë, Berzhitë, BERZHITË, Autostrada Tiranë – Elbasan, Km.6, “PALMA NOVA”.**

Procedura e prokurimit: “E Hapur - Punë”, prokurim elektronik.

Numri i referencës së procedurës: REF-81867-09-29-2023

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksion i rrjetit ‘TU’ 0.4Kv me kabëll ‘A.B.C’ në njësinë Peshkopi, Drejtoria Rajonale Burrel, “Zonat Guri i Kuq, Bellova, Pularia”, me fond limit në vlerën: 179 346 634 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e treqind e dyzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, me afat realizimi: 290 (dyqind e nëntëdhjetë) ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Publikime të mëparshme: nuk ka patur

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 84, datë 9 Tetor 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “ABG Ndertim” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K03816401O**, dhe “LA - OR” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K71420003R**,

Vlera: **172 492 727** (njëqind e shtatëdhjetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH;

2. Operatori Ekonomik: “EVEREST” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J78311921L**,

Vlera: **175 991 901** (njëqind e shtatëdhjetë e pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e një) lekë pa TVSH.

## Drejtoria Rajonale Burrel

3. Operatori Ekonomik: “**aci engineering**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L51609014F**,  
Vlera: *Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.*

### Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: “**EVEREST**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J78311921L**,  
2. Operatori Ekonomik: “**aci engineering**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L51609014F**.

### *Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:*

- ❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “**EVEREST**” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/Kualifikimit, si më poshtë:

- I. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 1 gërma “b”**/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur *Sigurimi i Ofertës, sipas Shtojcës 3.*
- II. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.5**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar për disponimin/kontraktimin e/me një laborator testimi të materialeve.
- III. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.6**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar, si: *Autorizimet e prodhuesit/ distributorit, Katalogjet dhe Dëshmitë e testimave zyrtare të kryera, për listën e mallrave/ materialeve të kërkuar.*
- IV. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.8 gërma “a”**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, në seksionin B: **DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”/ Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, nuk është deklaruar disponimi i minimumit 2 (dy) Inxhinier Elektrik, por vetëm 1 (një) të tillë.**
- V. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.10 gërma “a”**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, në seksionin C: **DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”/ Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, nuk ka deklaruar se disponon:**  
- 2 (dy) Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 12-18 ton, por vetëm 1 (një) të tillë.

## Drejtoria Rajonale Burrel

- 3 (tre) Ekskavator me goma, por vetëm 2 (dy) të tillë.
- 3 (tre) Fadromë, por vetëm 1 (një) të tillë.
- 3 (tre) Autobetoniere me kapacitet deri në 3.5 m<sup>3</sup> për punime në kantier, por vetëm 1 (një) të tillë.

VI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.12/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur mostrat për pajisjet/materialet e kërkuar ditën e hapjes së ofertave pranë autoritetit kontraktor.

VII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.13/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur grafiku i punimeve.

- ❖ Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vërejti se Operatori Ekonomik Pjesëmarrës: “**aci engineering**” Sh.p.k., nuk ka paraqitur Ofertë Ekonomike (sipas Shtojcës 1 të DST-së) në zbatim të nenit 29 të Vendimit Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 e dokumentat për përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit e kërkuar në DST,

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: “ABG Ndertim”** Sh.p.k., me seli: Tiranë, Tiranë, TIRANË, Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga “Ali Demi”, Ambientet e ish Kombinatit Poligrafik, Godinë 2 Katëshe, ngjitur me Spitalin Continental, Pronë e Kryegjyshitës Bektashiane, Tiranë, Shqipëri, me numër Nipt-i: **K038164010**, dhe “**LA - OR**” Sh.p.k., me seli: Tiranë, Berzhitë, BERZHITË, Autostrada Tiranë – Elbasan, Km.6, “PALMA NOVA”, me numër Nipt-i: **K71420003R**, se oferta e paraqitur me vlerë të përgjithshme prej: **172 492 727** (njëqind e shtatëdhjetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e njëzet e shtatë) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Drejtorisë Rajonale e OSSH, Burrel/ Dega e Shërbimeve Mbështetëse, me adresë: Rruga “Ibrahim Temo”, lagja “Partizani”, Burrel] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10 (dhjetë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

## Drejtoria Rajonale Burrel

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**Titullari i Autoritetit Kontraktor**